



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:105530

Datë: 19.08.2024

Numri i dokumentit: 06060588

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual , me sekretaren juridike Azemine Berisha, në lëndën kontestimore të paditësve R. K. , M. I. , E. C. , S. L. , të gjithë nga Hani i Elezit, të cilit i përfaqëson Avokati Q. B., nga Kaçaniku kundër të paditurës K. H. i E., për çështjen kontestuese pagesa e shujtave, në seancën gjyqësore më 18.07.2024, ndërsa me datën 16.08.2024, bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T V E N D I M

I. Padia e paditësve R. K. , M. I. , E. C. , S. L. , të gjithë nga Hani i Elezit, e ushtruar më datën 25.05.2022, kundër të paditurës, K. H. i E., për çështjen kontestuese kompensim dëmi , pranohet SI E TËRHEQUR.

II. DETYROHEN, paditësit qe në mënyrë solidare, kësaj gjykate t' ia paguaj shumën prej 20€, në emër të taksës për padi , e cila pagës do të bëhet në afat prej 7 ditëve.

A r s y e t i m

Paditësit përmes te autorizuarit, më datën 25.05.2022, në Gjykatën Themelore në Ferizaj- Dega në Kaçanik, kanë ushtruar padi kundër të paditurës, K. H. i E..

Me këtë padi kanë kërkuar qe të detyrohet e paditura, qe t'ia paguaj shumat e kërkuara , si në petitumin e padisë, këto shuma i kanë kërkuara me kamate prej 8%, duke filluar qe nga data e ushtrimit te padisë gjere ne pagesën përfundimtare. Po ashtu, ka kërkuar edhe shpenzimet e

procedurës kontestimore, te gjitha ne afatin prej 15 ditëve, nen kërcënimin e përmbartimit te dhunshëm.

Gjykata me datën 18.07.2024, e ka mbajtur seancën kryesore , në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësve, ndërsa e paditura nuk ka prezantuar. I autorizuari i paditësve e ka tërhequr padinë me arsyetim se këto shuma janë kërkuar në procedurë përmbartimore.

Gjykata duke pas për baze kërkesën e palës paditëse dhe duke vepruar sipas dispozitës se nenit 261. 2 të LPK-së, është e paraparë se pala paditëse mund ta tërheq padinë edhe ma vonë deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor , në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë, e në rastin konkret e paditura e ka dhen pëlqimin përmes telefonit, dhe e ka njoftuar gjykatën se kjo çështje është duke u zhvilluar në procedurë përmbartimore.

Gjykata aktvendimin e ka nxjerr duke u bazuar në nenit 261 par.3 të LPK-së, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata i detyroi paditësit qe në mënyrë solidarë, ta paguajnë shumën prej 20.00€, në emër të taksës për padi, sepse pala paditëse, nuk e ka paguar taksën me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë, ashtu siq është paraparë me neni 253.4 të LPK-së dhe Udhëzimit Administrativ.

Nga se u theksua më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.2022:105531 prej datës 19.08.2024

Gjyqtari

Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit të Kosovës me seli në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Dërguar me datën 20.08.2024